



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 343/3 prot.

Tiranë, më 02.07.2020

**VENDIM**  
**Nr.48, datë 02.07.2020**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT**  
**TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 120, DATË 07.11.2019,**  
**NË INSTITUCIONIN BASHKIA HIMARË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 120, datë 07.11.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Himarë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”*,

**KONSTATOVA SE:**

Me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, *“Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”*, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku u përfshi dhe Bashkia Himarë.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Himarë, vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 120, datë 07.11.2019, duke i

lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 3 (tre) muajsh për zbatimin e tyre.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Himarë, me shkresën nr.1390/1 prot., datë 28.5.2020, "*Kthim përgjigje shkresës me nr. 343 prot., datë 21.5.2020*", dhe përmes komunikimit në rrugë elektronike në datën 30 qershor 2020, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Himarë, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Sipas akteve të administruara në dosjen e verifikimit rezulton se, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit, duke ndërprerë marrëdhënien e punësimit në kundërshtim me ligjin, për punonjësit: \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, dhe \*\*\*\*\*.
2. Janë bërë ndryshimet përkatëse të emërtesave të pozicioneve të punës. Konkretisht, pozicionet "*Punonjës Arkive*", "*Punonjës Protokoli*" dhe "*Teknik Pyjesh*" janë konsideruar pozicione administrative, ndërsa pozicionet "*Punonjës i Financës*", "*Punonjës Arkitekt-Urbanist*", "*Punonjës Topograf*" janë konsideruar si pozicione pjesë e shërbimit civil duke ndryshuar emërtesat përkatësisht në: "*Specialist i Financës*", "*Specialist Arkitekt-Urbanist*", "*Specialist Topograf*".
3. Njësia përgjegjëse ka vijuar me procedurat e konkurrimit, duke realizuar një pjesë të tyre dhe po e vijon këtë proces sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore.
4. Me Vendimin nr. 2 prot., datë 09.01.2020, Bashkia Himarë ka hartuar planin vjetor të rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2020.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 "*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*" dhe Rregulloren, "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 120, datë 07.11.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Himarë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Himarë.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Himarë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**